



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 650 Prot.

Tiranë, më 21.04.2022

V E N D I M

Nr. 76, Datë 21. 04. 2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 63 Regj., datë 05.04.2022, të subjektit ankues A. P, kundër Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar” dhe të “etnisë³”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, ankuesi në mes të tjerash informon se: *“Zotëroj një titull studimi disiplinor në vitin 1992 për inxhinieri mekanike, tre tituj profesionalë për projektim dhe kolaudim të inxhinierisë mekanike dhe një titull për ekspert. Të gjithë titujt kanë hierarkinë e vet nga lart poshtë në kornizën shqiptare dhe evropiane, të cilët janë të certifikuar sipas ligjeve përkatëse kombëtare. Për këtë arsye i kam dërguar një kërkesë Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, në zbatim të nenit 43, pikave 1 dhe 2, të ligjit nr. 70/2016 “Për Zejtarinë në Republikën e Shqipërisë”, për ekuivalentimin e titullit tim me titullin “Mjeshtër” që jep ky institucion dhe për përjashtimin tim nga tarifat lidhur me këtë gjë. Titulli “Mjeshtër zejtar” më takon dhe nuk duhet të paguaj asnjë tarifë për të. Nëpërmjet shkresës me nr. 21/48 prot., datë 09.12.2021, Dhoma Kombëtare e Zejtarisë ka refuzuar dhënien e titullit “Mjeshtër” për mua me arsyetimin se nuk plotësoj kriteret për certifikimin me titullin “Mjeshër” dhe përjashtimin nga tarifat për procedurat”.*

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Ankuesi ka cituar tek formulari i ankesës se është me kombësi greke.

Referuar shkresës me nr. 21/48 prot., datë 09.12.2021, të Dhomës Kombëtare të Zejtarisë drejtuar subjektit ankues, rezulton se, pas shqyrtimit të dosjes dhe kërkesës së tij, lidhur me certifikimin e titullit “Mjeshtër” dhe përjashtim nga tarifat për procedurën, kanë konkluduar në përfundimin se ai nuk plotëson kriteret për certifikimin me titullin “Mjeshtër” dhe përjashtimin nga tarifat për procedurat.

Në shkresën e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë drejtuar ankuesit citohet shprehimisht se:

“Në kërkesën e bërë nga ana juaj nuk keni specifikuar se për cilin profesion zejtar bazuar në listën e profesioneve zejtare kërkonti certifikimin për titullin “Mjeshtër”. Ju bëjmë me dije se, në bazë të VKM nr. 578, datë 22.07.2020 “Për përcaktimin e listës së profesioneve zejtare” ekzistojnë 110 profesione zejtare. Do ju luteshim të përcaktoni se për cilin nga profesionet zejtare kërkonti të certifikoheni me titullin “Mjeshtër”. Neni 43, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 70/2016 “Për Zejtarinë në Republikën e Shqipërisë”, ju lejon të aplikoni në rast se keni një profesion zejtar bazuar në listën e profesioneve zejtare, por duke përmbushur kriteret të cilat janë miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, kriteret të cilat ju janë vënë në dispozicion nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë. Dispozitat ligjore të cituara prej jush, nuk parashikojnë në asnjë fragment përjashtimin nga tarifa për marrjen e titullit “Mjeshtër”. Neni 43, pika 2 e këtij Ligji, përcakton përjashtimin nga tarifat për subjektet zejtare të cilat janë ndërmarrje sociale.

Ndërmarrjet Sociale janë të rregulluara në ligjin nr. 65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”, i cili, në nenin 12, pikat 1 dhe 2 të tij, përcakton se... “1. Ndërmarrjet Sociale janë organizata jofitimprurëse, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse. 2. Pas përfitimit të statusit të ndërmarrjes sociale është i detyrueshëm përdorimi i emërimit “Ndërmarrje Sociale” në krah të organizatës”. Gjatë shqyrtimit të dosjes tuaj nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë se ju jeni kryetar i një ndërmarrjeje sociale. Në asnjë dokument nuk është përdorur emërtimi ndërmarrje sociale në krah të organizatës. Në bazë të dokumentacionit të dërguar ju paraqiteni si ekspert privat “Zjarrfikës”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, t’i jepet titulli “Mjeshtër” nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë, si dhe të përjashtohet nga tarifat për procedurat që duhen ndjekur për marrjen e këtij titulli.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkaqet e pretenduara⁴ nga ana e subjektit ankues.

1. Për këtë arsye, me shkresën nr. 31/1 prot., datë 24.01.2022 i është kërkuar ankuesit të sqarojë shkaqet e pretenduara, të dokumentojë e provojë secilin prej tyre, si dhe situatën diskriminuuese, bazuar në secilin nga shkaqet e pretenduara.

Në vijim të shkresës sipërcituar, subjekti ankues, me datë 28.03.2022, ka dërguar pranë KMD-së, sërish të njëjtat pretendime ndaj Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, duke evidentuar se ndjehet i

⁴ Subjekti ankues ka sigluar tetë shkaqe të listës së formularit të ankesës: etni, bindje fetare, bindje filozofike, gjendje ekonomike, gjendje arsimore, gjendje shoqërore, gjendje shëndetësore dhe aftësi të kufizuar, pa asnjë dokument, provë apo shpjegim bashkëlidhur.

diskriminuar nga ana e këtij institucioni, duke pretenduar se i është mohuar e drejta ligjore e tij, për njohjen e titullit “Mjeshtër”, bazuar në dispozitat ligjore të ligjit nr. 70/2016 “Për zejtarinë në Republikën e Shqipërisë”. Në shkresë ka cituar se është person me aftësi të kufizuar dhe se bën pjesë tek pakicat kombëtare, por nuk ka bashkëlidhur asnjë dokument apo provë për të vërtetuar shkaqet e pretenduara.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar⁵, në nenin 3/1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “aftësia e kufizuar” dhe “etnia”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar shkaqet e pretenduara.

Për sa më sipër, shkak i diskriminimit përbën një element kyç në hetimin administrativ të Komisionerit, si dhe duhet vërtetuar me prova të mbështetura në fakte konkrete.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin ankuesi pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat, si mospërfitimi i titullit “Mjeshtër” dhe përjashtimi nga pagesa e tarifave procedurale lidhur me përfitimin e tij.

⁵ Referuar në vijim me shkurtesën LMD.

Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga ankuesi lidhen pikërisht me këtë “shkak” apo këto “shkaqe”.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh. Neni 1, i këtij Ligji, është në të njëjtën linjë me parashikimet e nenit 14, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së).

Gjatë shqyrtimit të çështjeve me pretendim diskriminim bazuar në shkaqet e parashikuara në LMD, Komisioneri, gjithashtu, i referohet edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës, si dhe me shkaqet e parashikuara në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”.*

Referuar citimit sa më lart, ankuesi nuk solli asnjë provë që të dokumentonte shkaqet e pretenduara prej tij.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të saj që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç dhe 10 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 63 Regj, datë 05.04.2022, të paraqitur nga shtetasi A. P kundër Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Shërbime

Shkaku: Aftësi e kufizuar, etni

Lloji i vendimit: Mospranim